




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.473/2022
Datë: 14 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 14 paragrafi 2, pika 2.2 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, në mbledhjen 300-të, të mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Znj. Mejreme Memaj, gjyqtare e Gjykatës Supreme, caktohet ushtrues i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.
- II. Znj. Memaj, do të shërben si ushtrues i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga data 14 dhjetor 2022 deri në emërimin e kryetarit të kësaj gjykate nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 14 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në takimin e mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, ka diskutuar çështjen e caktimit të ushtruesit të detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pas lirimit nga ushtrimi i funksionit të kryetarit të kësaj gjykate.

Me qëllim të menaxhimit efektiv dhe mbarëvajtjes së punëve në Gjykatën Supreme të Kosovës, në mungesë të kryetarit të gjykatës, KGJK caktoi ushtruesin e detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme znj. Mejreme Memaj, gjyqtare në Gjykatën Supreme deri në emërimin e kryetarit të kësaj gjykate nga KGJK, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Mejreme Memaj, gjyqtare në Gjykatën Supreme të Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK, si dhe
- Arkivit.

